

Takimi Ndërkombëtar i Rinisë Orthodoxke ITO 2026



Me bekimin e Shenjtërisë së Tij, Patriarkut të Rumanisë Daniel, dhe në përgjigje të ftesës zyrtare drejtuar Kishës Orthodoxke Autoqefale të Shqipërisë nga Kryepiskopi Joan, u zhvillua në Bukuresht Takimi Ndërkombëtar i Rinisë Orthodoxke ITO 2026.

Me temën qendrore “Rinia, Kisha dhe Jeta në Krishtin”, ky takim u dha një mundësi të rinjve orthodoxkë që të thellojnë jetën e tyre shpirtërore, të ndajnë përvoja dhe të reflektojnë mbi rolin e besimit në jetën e përditshme.

Kisha Orthodoxke Autoqefale e Shqipërisë është e pranishme në këtë takim përmes Hierodhjakon Nifonit dhe dy të rinj nga Kisha jonë.

ITO 2026 mbledhi rreth 2,400 të rinj orthodhoksë, të moshës 16–35 vjeç, nga Rumania dhe diaspora, duke sjellë së bashku të rinj nga vende dhe kultura të ndryshme, duke krijuar një hapësirë për bashkëpunim, miqësi, dialog dhe forcimin e lidhjes së tyre me Kishën dhe me Krishtin.

Patriarku i Rumanisë në mesazhin e tij për të rinjtë theksoi se e kriza kryesore që prek familjen është ajo “e shkaktuar nga humbja e kuptimit të shenjtërisë së jetës njerëzore dhe e dashurisë së përlurur dhe sakrifikuese. Për këtë arsye, është e nevojshme të riafirmohet rëndësia e familjes bashkëshortore dhe marrëdhënia e saj me familjen kishtare, ose bashkësinë eukaristike, të themeluar mbi bashkimin midis qenieve njerëzore dhe Zotit”.

Nga: Hierodhjakon Nifoni

[Radio “Ngjallja”](#)